

VENDIM
Nr. 489, datë 19.7.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110 KV ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 KV HIMARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110 kV Orikum dhe nënstacionit 110 kV Himarë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, OST sh.a-së.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompesimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 798.89 m² tokë arë, me shumën e përgjithshme 366 974 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit korrik 2017.

6. Çdo pronar, për t'u likuiduar për efekt shpronësimi, të dorëzojë pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar, lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110 KV ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 KV HIMARË
Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë arë

Nr.	Të dhëna për pronësinë							Sip. e shpronësimit për nënstacionin m²	Vlera e shpronësimit në lekë/m²	Vlera e shpronësimit në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m²				
Bashkia Vlorë											
Tragjas											
1	Merushe		Harizaj	3621	998/23	Arë	2046	1723.2	204	351533.0	
2	Krenar		Harizaj	3621	998/24	Arë	2046	75.69	204	15441.0	Bashkëpronësi
Sipërfaqe totale për shpronësim në m²								1798.89			
Shuma totale në lekë për shpronësim										366974	